STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 26 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON ZGJATJEN E AFATIT PERFUNDIMTAR PER NDIHMEN E KATASTROFES NGA FEMA

Banorët e trembëdhjetë qarqeve të shpalluara mund të aplikojnë për ndihmën në rast fatkeqësie nga FEMA deri më 13 prill 2013

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se afati përfundimtar për banorët që banojnë në një nga të trembëdhjetë qarqet e shpallura të shkatërruara për tu regjistruar për të marrë ndihmë nga FEMA është zgjatur deri më 13 prill 2013. Afati përfundimtar i mëparshëm ishte 29 mars 2013.

Ndihma federale e katastrofës për individët dhe familjet mund të përfshijë para për ndihmë me qiranë, riparime thelbësore të shtëpisë, nevoja të pronës personale të humbur dhe nevoja të tjera të rëndësishme që kanë lidhje me katastrofën jo të mbuluara nga sigurimi. Banorët në qarqet e mëposhtme kualifikohen për ndihmë: Bronks (Bronx), Kings (Kings), Naso (Nassau), Nju Jork (New York), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Uestçester (Westchester), Safolk (Suffolk), Kuins (Queens), Oranxh (Orange), Putnëm (Putnam), Sallivën (Sullivan) dhe Ulstër (Ulster).

"Tani që po afrohen gjashtë muaj qysh nga dita e super-stuhisë Sandy, shumë njujorkezë të dëmtuar nga uragani Sandy ende janë në nevojë dhe duhet të kenë mundësinë e përdorimit të ndihmës dhe burimeve në rast fatkeqësie, me qëllim që të ndihmohen për tu rimëkëmbur", tha guvernatori Cuomo. "Shtrirja e afatit kohor nga FEMA do tu japë banorëve të dëmtuar më tepër kohë për të marrë ndihmë me qëllim që të rindërtojnë sa më shpejt të jetë e mundur".

Kërkesa e shtetit gjithashtu përfshiu një zgjatje për 14 ditë për individët dhe bizneset që të bëjnë kërkesë pranë Administratës së Bizneseve të Vogla (Small Business Administration) për hua me interes të ulur.

Individët mund të rregjistrohen në internet në www.disasterassistance.gov [2] ose nëpërmjet telefonave inteligjentë ose kompjuterëve portative në m.fema.gov.

Aplikuesit mund të telefonojnë gjithashtu në 800-621-3362 ose (TTY) 800-462-7585. Aplikuesit që përdorin 7-1-1 Shërbimet me Rele ose Shërbimet me Rele Video (Video Relay Services) (VRS) mund të telefonojnë në 800-621-3362. Numrat telefonikë falas funksionojnë nga ora 7 në mëngjes deri në 1 të natës, shtatë ditë në javë, deri në një njoftim të mëtejshëm.

Numri telefonik falas i Qendrës për Shërbimin për Klientët e SBA për Katastrofën (SBA Disaster Customer Service Center) është: **800-659-2955 (TTY 800-877-8339)**. Ndihma është gjithashtu e disponueshme duke dërguar një e-mail tek DisasterCustomerService@sba.gov ose duke vizituar www.sba.gov.

Një mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë për të mbushur një aplikim të SBA në internet është e disponueshme në: https://DisasterLoan.SBA.gov/ELA.

Përfaqësues të FEMA dhe SBA janë të disponueshëm për t'u përgjigjur pyetjeve në çdo Qendër të Rimëkëmbjes nga Katastrofa (Disaster Recovery Center). Për të gjetur qendrën më të afërt të rimëkëmbjes nga katastrofa, përdorni gjetësin në www.FEMA.gov/disaster-recovery-centers ose, me një kompjuter portative ose një telefon intelligjet, shkoni te **m.fema.gov**.

Gjithashtu mund të dërgoni me tekst "DRC" dhe kodin tuaj (Zip Code) tek 43362 (4FEMA). Për shembull, nëse jetoni në Stejtën Ajlënd (Staten Island), do të dërgoni me tekst: DRC 10301. Ose telefononi në 800-621-3362 (TTY 800-462-7585).

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418